



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.321/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z.Goran Milenkovic - Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z.Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Office 1 Kosova” SH.P.K - Prishtinë kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për bibliotekën Hivzi Sylejmani”, me nr. prokurimit: 616-20-1331-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Prishtinë më datë: 25.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Office 1 Kosova” SH.P.K - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për bibliotekën Hivzi Sylejmani”, me nr. prokurimit: 616-20-1331-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Prishtinë.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues “Kuvendi Komunal Prishtinë” ti bëj ndryshimet e nevojshme në dosjen e tenderit në pajtim me dispozitat e LPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për bibliotekën Hivzi Sylejmani”, me nr. prokurimit: 616-20-1331-1-2-1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Office 1 Kosova” SH.P.K-Prishtinë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues: “Office 1 Kosova” SH.P.K - Prishtinë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 22.05.2020, me nr. 321/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për bibliotekën Hivzi Sylejmani”, me nr. prokurimit: 616-20-1331-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Prishtinë duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin : 1, 6, 7, 52, 53 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.05.202 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, në raportin e dt: 04.06.2020 sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues në ankesën e tij ka pretendime që AK-ja, me rastin e hartimit të kërkesave të dosjes së tenderit ka favorizuar duke kërkuar marrëveshjen me shtëpinë botuese për furnizim me libra dhe njëherit OE ankues jep argumentin e tij se ka kërkuar marrëveshje nga disa shtëpi botuese në Shqipëri dhe se e njëjta i është përgjigjur se tani më kanë një marrëveshje me një operator ekonomik tjetër.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka kërkuar nga disa shtëpi botuese që ti ofrojnë marrëveshje dhe njëherit, qëndron fakti se disa i janë përgjigjur negativisht me arsyetimin se tani veç kanë marrëveshje me një operator ekonomik tjetër, mirëpo i njëjti nga një shtëpi tjetër botuese ka marr edhe përgjigje që për shkak të situatës së pandemisë e kanë të pamundur që të mbledhet bordi dhe të vendos për një kërkesë të një operatori ekonomik. Andaj, fakti se ka shtëpi tjera botuese të librave të cilat i ka kërkuar AK-ja, nuk mund të konsiderohet si kërkesë diskriminuese dhe favorizuese dhe po ashtu fakti, që tani më vetëm ka kaluar kjo situatë si operator ekonomik mund ti drejtohet përsëri shtëpive botuese tjera me kërkesë për marrëveshje.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK-ja nuk është përgjigjur në një kërkesë për sqarim e cila mban datën: 30.04.2020, eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se OE ankues pyetjen të cilën e ka hartuar e ka bashkangjitur në ankesën të cilën e ka deponuar në OSHP, mirëpo në sistemin e e-prokurimit e njëjta kërkesë nuk gjendet.

Në fund, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e OE ankues është e pabazuar, për faktin se marrëveshjet me shtëpitë botuese janë të mundshme dhe njëherit sqaron se pretendimet për shkelje të neneve të përmendura në ankesën e OE ankues janë të paqëndrueshme.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe të lejohet që AK-ja të vazhdojë më tutje me procedurat e prokurimit.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 09.06.2020, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 08.06.2020, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Office 1 Kosova” SH.P.K - Prishtinë se AK me rastin e hartimit të kërkesave të dosjes së tenderit ka favorizuar duke kërkuar marrëveshjen me shtëpinë botuese për furnizim me libra dhe njëherit OE ankues jep argumentin e tij se ka kërkuar marrëveshje nga disa shtëpi botuese në Shqipëri dhe se e njëjta i është përgjigjur se tani më kanë një marrëveshje me një operator ekonomik tjetër.

Paneli Shqyrtues sqaron se për këtë kërkesë të AK-së, OE ankues i është drejtuar disa shtëpive botuese me kërkesë që të lidhin marrëveshje dhe këto shtëpi botuese i janë përgjigjur negativisht me arsyetimin se tani veç kanë marrëveshje me një operator ekonomik tjetër. Mirëpo, një shtëpi tjetër botuese i ka kthyer përgjigje OE ankues duke i thënë që për shkak të situatës së pandemisë e kanë të pamundur që të mblidhet bordi dhe të vendos për një kërkesë të një operatori ekonomik. Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh kërkesën e AK-së për marrëveshje me shtëpinë botuese për furnizim me libra dhe përgjigjen e shtëpive botuese të cilat i kishin thënë OE ankues që tanimë kanë marrëveshje me një OE, sqaron se kjo kërkesë e AK-së paraqet elemente të reduktimit apo eliminimit të konkurrencës në kundërshtim me nenit 7 të LPP-së. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se kjo kërkesë e AK është në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së sepse kjo kërkesë po ashtu do të ndikonte në mos arritjen e qëllimit për këtë aktivitet të prokurimit, rrjedhimisht me këtë kërkesë të AK nuk do

të ketë siguri që do të arrihet qëllimi i prokurimit për këtë aktivitet. Pra, çmimi i ofruar do të jetë në dorë të një OE dhe AK nuk do të ishte në gjendje që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike sepse vetëm një OE posedon një marrëveshje të tillë siç ka kërkuar AK.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Office 1 Kosova” SH.P.K - Prishtinë se AK-ja nuk është përgjegjës në një kërkesë për sqarim e cila mban datën: 30.04.2020. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues pyetjen të cilën e ka hartuar e ka bashkangjitur në ankesën të cilën e ka deponuar në OSHP. Mirëpo, kjo pyetje nuk gjendet në sistemin e e-prokurimit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerëson se autoriteti kontraktues me rastin e përpilimit të dosjes së tenderit ka caktuar kërkesa të cilat do të ndikonin në reduktimin apo eliminimin e konkurrencës në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se kërkesa e AK-së se “OE duhet të ketë marrëveshje me shtëpinë botuese...” dhe mos pranimi i shtëpive botuese që të lidhin marrëveshje me të tjerë OE do të ndikoj në arritjen e qëllimit, si dhe kërkesa e tillë nga AK është në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së sepse kjo kërkesë do të ndikonte në mos arritjen e qëllimit për këtë aktivitet të prokurimit, rrjedhimisht me këtë kërkesë të AK nuk do të ketë siguri që do të arrihet qëllimi i prokurimit për këtë aktivitet. Pra, çmimi i ofruar do të jetë në dorë të një OE dhe AK nuk do të ishte në gjendje që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike sepse vetëm një OE posedon një marrëveshje të tillë siç ka kërkuar AK. Andaj, obligohet AK që ti bëjë përmirësimet e nevojshme në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Prishtinë
- 1x1 OE- “Office 1 Kosova” SH.P.K-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.